Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 14.10.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për krasitjen dhe prerjen e drunjve të dëmtuar në qytet, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e krasitjes dhe prerjen e drunjve të dëmtuar në qytet, kështu që për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 14.10.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e infrastrukturës së jashtme në oborret e Zyres së Gjendjes Civile në Tusus dhe Zym, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e rregullimit të infrastrukturës së jashtme, përkatësisht për vendosjen e rrethojave metalike në Zyrën e Gjendjes Civile në Tusus dhe Zym si dhe për rregullimin me kubëza të betonit të oborrit të Zyrës së Gjendjes Civile në Zym, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145604
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për ShKA "Agimi" nga Prizreni, kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të ShKA "Agimi" nga Prizreni, me qëllim të organizimit dhe kremtimit të përvjetorit jubilar të 70-të të themelimit të këtij subjekti kulturor, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 5000 €.

II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve dhe atë:

a. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, lejohen mjetet në shumën prej 1000 €,

b. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, lejohen mjete në shumën prej 1000 €.

c. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, lejohen mjetet në shumën 500 €, dhe

d. Prej pozicioneve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe pozicioneve të drejtorive të tjera komunale, lejohen mjete në shumën prej 2500 €.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtorit e lartcekura dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145607
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për përkrahje financiare për KF "Liria", kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 7.10.2014, për përkrahje financiare për KF "Liria", me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për nevojat e klubit, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjete financiare në lartësi prej 9500 €.

II. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KF "Liria", si dhe arkivi.

V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 14.10.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit-planit të hollësishëm urban për Bjeshkën e Kabashit, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e hartimit të projektit-planit të hollësishëm urban për Bjeshkën e Kabashit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me 14.10.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për vendosjen e Info Qendrës Turistike në lagjen "Bazhdarhane",dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e vendosjes së Info Qendrës Turistike në lagjen "Bazhdarhane", kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Info Qendra Turistike është paraparë që të vendoset në anën e djathtë të hyrjes në qytet nga ana e Suharekës, afër Çerdhes së Fëmijëve, në lagjen "Bazhdarhane";

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145613
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit dhe të Ligjit për Veterinarinë nr. 2004/21, kryetari i Komunës, me 14 tetor 2014, mori këtë

# AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni komunal për përcaktimin e lokacionit për groposjen e trupave të kafshëve të ngordhura. Anëtarë të këtij komisioni, emërohen:

a. Pal Geci -drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryesues,
b. Eroll Hallqe-Drejtoria e Inpektorateve,
c. Gursel Skenderi-Sektori i Pronës,
d. Ramadan Tafallari-Drejtoria e Shërbimeve Publike, dhe
e. Dukagjin Berisha-Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastër, anëtar.

II. Detyrat e Komisionit nga pika I e këtij Aktvendimi janë të parapara në Ligjin për Veterinarinë nr. 2004/21, Udhëzimit Administrativ MA nr. 10/2005si dhe Vendimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë- Ref. 01-414/14, datë 17.9.2014.

III. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe të emëruarit.

IV. Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të emëruarit, Ministria përkatëse dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145617
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Njësisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare të Fushatës Kundër Kancerit në Gji, kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

I. Miratohet propozimi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare të Fushatës Kundër Kancerit në Gji, kështu që për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të pagesës së ligjërueses, (do të mbahen dy ligjërata lidhur me fushatën e lartcekur), lejohen mjetet në shumën prej 100 €.

II. Të gjitha femrat e interesuara nga Komuna e Prizrenit, lirohen nga participimi për realizimin e kontrolleve mjekësore në QKMF, me anë të ultrazërit dhe mamografisë gjatë kësaj fushate (15.10.2014 deri me 30.11.2014).

III. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave e shërbimeve dhe subvencioneve të Komunës së Prizrenit.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

V. Me këtë Vendim të njoftohen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

VI. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja,

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 14.10.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e objektit të AMF-së në fshatin Velezhë, dhe mori këtë

## K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e ndërtimit të objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Velezhë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 14.10.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e fushës sportive, oborrit dhe rrugës në ShMT "11 Marsi", dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e rregullimit të fushës sportive, oborrit dhe rrugës pas objektit shkollor në Shkollën e Mesme Teknike "11 Marsi" në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Rregullim i kësaj infrastrukture do të bëhet nga buxheti vetanak i ShMT "11 Marsi".

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-141662
Më 14.10.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 14.10.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për shtruarjen e dyshemeve të klasave me laminat në gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shtruarjes së dyshemeve të klasave me laminat në gjimnazin "Gjon Buzuku" në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Rregullim i kësaj infrastrukture do të bëhet nga buxheti vetanak i gjimnazit "Gjon Buzuku".

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145620
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e zhvillimit të procedurave për hapjen e kanalit për lidhjen (kyçjen) me rrymë elektrike të Qendrës së Kompetencës, kryetari i Komunës më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e zhvillimit të procedurave për hapjen e kanalit për lidhjen (kyçjen) me rrymë elektrike të Qendrës së Kompetencës, kështu që për realizimin e këtij projekti (hapja e kanalit, etj,) lejohet shfrytëzimi i kontratës me operatorin ekonomik i cili bën mirëmbajtjen e ndriçimit publik në Komunën e Prizrenit.

II. Në emër të punimeve të kryera, të përshkruar si në nenin I të këtij Vendimi, lejohen mjetet e nevojshme financiare nga buxheti i Komunës – pozicionet buxhetore të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

IV. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, operatori ekonomik, si dhe arkivi.

V. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145624
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Ajradin Alija, shef i ZKK-së, kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ajradin Alija, shef i ZKK-së për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që ka të bëj me vlerësimin, analizën dhe planifikimin e projekteve EU-RRK III-IV, që organizohet nga IOM. Punëtoria do të mbahet nga data 16 tetor deri me 18 tetor 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-145626
Më 14.10.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Malit të Zi dhe pagesës së mëditjeve për Flamur Hotin dhe Deli Delijajn, zjarrfikës në Komunën e Prizrenit, kryetari i Komunës, më 14 tetor 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri, për lejimin e udhëtimit zyrtar dhe pagesën e mëditjeve për Flamur Hotin dhe Deli Delijajn, zjarrfikës në Komunën e Prizrenit, për në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që ka të bëjë me ushtrimi fushor. Trajnimi do të mbahet nga data 20 tetor deri me 24 tetor 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja